Blv. Zhan d'Ark , nr. 3
Tiranë, 1001
Tel: +355 4 2222 411
Faks: +355 4 2228300

info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

# Indeksi i Çmimeve të Prodhimit

## Tremujori I, 2015

**Tiranë, më 05 Qershor:** Në tremujorin e parë të vitit 2015, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit arriti 101,5 % kundrejt vitit 2010. (Viti 2010 = 100).

**Në tremujorin e parë 2015 ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Prodhimit është -1,8.** Uljen më të lartë e kanë shënuar çmimet e prodhimit në seksionin: " Industri nxjerrëse" me 9,6 %.

Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2014, çmimet e prodhimit të produkteve për eksport kanë shënuar rritje me 0,8%. Çmimet e prodhimit të produkteve vendase shënuan ulje me 3,4%.

**Në tremujorin e parë 2015 ndryshimi tremujor i indeksit është -0,4 %.** Çmimet e Prodhimit në seksionin "Industri Nxjerrëse" shënuan ulje me 3,1 % krahasuar me tremujorin e katërt 2014. Uljen më të lartë e shënuan çmimet e prodhimit në aktivitetin "Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror" me 5,7 %.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve të industrisë përpunuese shënoi rritje me 0,6 %. Brenda kësaj industrie mund të përmendet rritja e çmimeve të produkteve në aktivitetet: "Prodhimi i mobiljeve" me 4,9 %,"Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike" me 2,8 % dhe "Përpunimi i letrës dhe produkteve prej letre" me 2,5 %. Ndërsa çmimet e prodhimit të produkteve në aktivitetet: "Përpunimi i koksit, rafineria e nënprodukteve të naftës" dhe "Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve" shënuan ulje respektivisht 2,4 % dhe 3,1 %.

**Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për produktet vendase** arriti 99,5 % duke shënuar një ulje me 1,2 % krahasuar me tremujorin e katërt 2014 (Viti 2010 = 100). Vlen të përmendet ulja e çmimeve të prodhimit të produkteve në seksionin "Industri Nxjerrëse" me 6,8 %. Çmimet e prodhimit për produktet vendase në seksionin "Industri përpunuese" shënuan rritje me 0,6 %.

**Indeksi i Çmimeve të Eksportit** arriti 104,6 % duke shënuar një rritje me 0,1 % krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Çmimet e prodhimit të produkteve për eksport kanë shënuar rritje në seksionin "Industri përpunuese" me 0,5 %.

**Për publikim 05/06/2015**

*Vijon*

## Fig. 1 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit sipas muajve , Janar 2014 – Mars 2015




## Fig. 2 Struktura e seksioneve të industrisë



**Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit**

2010=100 %

| NVE | | Përshkrimi | Peshat | 01 - 15 | 02 - 15 | 03 - 15 | I - 15 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Gjithsej** | **100,0** | **101,2** | **101,7** | **101,7** | **101,5** |
| B | | Industri Nxjerrëse | **23,9** | **92,8** | **94,4** | **95,3** | **94,1** |
| | 05 | Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve | 0,1 | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 100,0 |
| | 06 | Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror | 15,9 | 92,7 | 95,7 | 96,7 | 95,0 |
| | 07 | Nxjerrja e mineraleve metalore | 5,4 | 101,2 | 99,3 | 100,7 | 100,4 |
| | 08 | Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat | 2,5 | 101,9 | 101,8 | 101,8 | 101,8 |
| **C** | | Industria Përpunuese | **60,0** | **104,9** | **105,0** | **104,7** | **104,9** |
| | 10 | Përpunimi i produkteve ushqimore | 9,5 | 106,7 | 106,7 | 106,8 | 106,7 |
| | 11 | Prodhimi i pijeve | 3,3 | 108,5 | 108,1 | 106,0 | 107,5 |
| | 12 | Prodhimi i produkteve të duhanit | 0,2 | 92,6 | 92,6 | 92,6 | 92,6 |
| | 13 | Përpunimi i tekstileve | 0,2 | 106,6 | 106,6 | 106,6 | 106,6 |
| | 14 | Konfeksionimi i veshjeve | 4,5 | 106,9 | 106,4 | 106,9 | 106,8 |
| | 15 | Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure | 5,1 | 108,4 | 108,5 | 109,1 | 108,6 |
| | 16 | Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi | 1,2 | 109,6 | 109,6 | 109,7 | 109,6 |
| | 17 | Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre | 0,9 | 106,1 | 106,1 | 106,1 | 106,1 |
| | 18 | Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara | 1,6 | 94,0 | 94,0 | 94,0 | 94,0 |
| | 19 | Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës | 1,4 | 108,1 | 109,3 | 108,1 | 108,5 |
| | 20 | Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike | 1,1 | 100,1 | 100,1 | 100,1 | 100,1 |
| | 21 | Përpunimi I produkteve dhe preparateve farmaceutikë | 0,3 | 97,4 | 97,4 | 97,4 | 97,4 |
| | 22 | Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës | 1,5 | 116,2 | 116,2 | 116,2 | 116,2 |
| | 23 | Prodhimi i produkteve minerale jo metalike | 10,7 | 101,8 | 101,8 | 100,8 | 101,5 |
| | 24 | Metalurgjia | 8,7 | 94,7 | 95,7 | 95,2 | 95,2 |
| | 25 | Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve | 6,2 | 106,2 | 105,9 | 105,9 | 106,0 |
| | 26 | Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë | 0,0 | 104,8 | 104,8 | 104,8 | 104,8 |
| | 27 | Prodhimi i paisjeve elektrike | 0,6 | 110,0 | 110,0 | 110,0 | 110,0 |
| | 28 | Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p.k.t | 0,1 | 109,7 | 109,7 | 109,7 | 109,7 |
| | 29 | Prodhimi I mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove | 0,3 | 103,7 | 103,7 | 103,7 | 103,7 |
| | 31 | Prodhimi i mobiljeve | 2,1 | 116,6 | 116,7 | 116,4 | 116,6 |
| | 32 | Industri të tjera p.k.t | 0,3 | 105,2 | 105,2 | 105,2 | 105,2 |
| | 33 | Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve | 0,1 | 107,7 | 105,9 | 109,4 | 107,7 |
| **D** | | Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar | **11,6** | **99,4** | **99,8** | **98,9** | **99,4** |
| | 35 | Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar | 11,6 | 99,4 | 99,8 | 98,9 | 99,4 |
| **E** | | Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve | **4,6** | **101,9** | **102,5** | **103,0** | **102,4** |
| | 36 | Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve | 2,1 | 112,2 | 112,2 | 112,2 | 112,2 |
| | 37 | Shërbime të trajtimit të kanalizimeve | 0,4 | 101,5 | 101,5 | 101,5 | 101,5 |
| | 38 | Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve | 2,1 | 85,6 | 86,8 | 87,7 | 86,7 |

**Tab.2 Ndryshimet tremujore dhe vjetore të Indeksit të Çmimeve të Prodhimit**

%

| NVE | Përshkrimi | Peshat | I-15 / IV–14 | I- 15 / I- 14 |
|---|---|---|---|---|
| | **Gjithsej** | **100,0** | **-0,4** | **-1,8** |
| | **Industri Nxjerrëse** | **23,9** | **-3,1** | **-9,6** |
| 05 | Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve | 0,1 | 0,0 | 0,0 |
| 06 | Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror | 15,9 | -5,7 | -14,7 |
| 07 | Nxjerrja e mineraleve metalore | 5,4 | 3,5 | 3,6 |
| 08 | Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat | 2,5 | 0,5 | 0,5 |
| | Industria Përpunuese | **60,0** | **0,6** | **0,5** |
| 10 | Përpunimi i produkteve ushqimore | 9,5 | 0,9 | 1,8 |
| 11 | Prodhimi i pijeve | 3,3 | 1,7 | 2,5 |
| 12 | Prodhimi i produkteve të duhanit | 0,2 | 0,0 | -8,3 |
| 13 | Përpunimi i tekstileve | 0,2 | 0,6 | 5,6 |
| 14 | Konfeksionimi i veshjeve | 4,5 | 1,8 | 2,3 |
| 15 | Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure | 5,1 | -0,9 | -5,0 |
| 16 | Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi | 1,2 | -0,5 | 0,2 |
| 17 | Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre | 0,9 | 2,5 | 4,3 |
| 18 | Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara | 1,6 | 0,0 | 0,5 |
| 19 | Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës | 1,4 | -2,4 | -3,4 |
| 20 | Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike | 1,1 | 2,8 | 1,4 |
| 21 | Përpunimi I produkteve dhe preparateve farmaceutikë | 0,3 | 0,0 | -1,4 |
| 22 | Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës | 1,5 | -0,1 | 1,7 |
| 23 | Prodhimi i produkteve minerale jo metalike | 10,7 | 0,4 | -2,2 |
| 24 | Metalurgjia | 8,7 | -0,4 | 1,8 |
| 25 | Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve | 6,2 | 0,4 | 1,7 |
| 26 | Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë | 0,0 | 0,3 | 0,3 |
| 27 | Prodhimi i paisjeve elektrike | 0,6 | 0,5 | 4,4 |
| 28 | Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p.k.t | 0,1 | -0,1 | -0,3 |
| 29 | Prodhimi I mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove | 0,3 | 3,0 | 3,0 |
| 31 | Prodhimi i mobiljeve | 2,1 | 4,9 | 4,9 |
| 32 | Industri të tjera p.k.t | 0,3 | -2,1 | -3,1 |
| 33 | Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve | 0,1 | -3,1 | -2,5 |
| | Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar | **11,6** | **-0,8** | **-0,8** |
| 35 | Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar | 11,6 | -0,8 | -0,8 |
| | Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve | **4,6** | **-0,8** | **-0,5** |
| 36 | Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve | 2,1 | 2,3 | 3,9 |
| 37 | Shërbime të trajtimit të kanalizimeve | 0,4 | -0,4 | -1,8 |
| 38 | Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve | 2,1 | -4,1 | -5,4 |

## Tab. 3 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për tregun vendas

2010 = 100 %

| NVE | | Përshkrimi | Peshat | 01 - 15 | 02 - 15 | 03 - 15 | I - 15 | I-15 / IV-14 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Gjithsej** | **100,0** | **98,9** | **100,1** | **99,5** | **99,5** | **-1,2** |
| B | | Industri Nxjerrëse | 25.3 | **91,9** | **98,3** | **97,2** | **95,8** | **-6,8** |
| | 05 | Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve | 0,1 | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 0,0 |
| | 06 | Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror | 13,6 | 93,0 | 102,3 | 100,8 | 98,7 | -9,8 |
| | 07 | Nxjerrja e mineraleve metalore | 1,2 | 115,8 | 115,8 | 115,8 | 115,8 | 4,1 |
| | 08 | Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat | 3,9 | 102,2 | 102,1 | 102,1 | 102,1 | 0,3 |
| C | | Industria Përpunuese | **57,1** | **103,5** | **103,3** | **102,9** | **103,2** | **0,6** |
| | 10 | Përpunimi i produkteve ushqimore | 11,8 | 107,7 | 107,6 | 107,8 | 107,7 | 1,7 |
| | 11 | Prodhimi i pijeve | 5,3 | 107,9 | 107,6 | 105,4 | 107,0 | 1,8 |
| | 12 | Prodhimi i produkteve të duhanit | 0,3 | 92,6 | 92,6 | 92,6 | 92,6 | -4,8 |
| | 13 | Përpunimi i tekstileve | 0,1 | 87,4 | 87,4 | 87,4 | 87,4 | 1,9 |
| | 14 | Konfeksionimi i veshjeve | 2,3 | 106,2 | 104,5 | 105,7 | 105,5 | 1,4 |
| | 15 | Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure | 2,6 | 113,2 | 112,1 | 113,5 | 113,0 | -2,9 |
| | 16 | Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi | 1,1 | 104,8 | 104,8 | 104,9 | 104,8 | -0,4 |
| | 17 | Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre | 0,4 | 108,8 | 108,8 | 108,8 | 108,8 | 5,6 |
| | 18 | Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara | 2,7 | 94,0 | 94,0 | 94,0 | 94,0 | -6,8 |
| | 19 | Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës | 0,9 | 103,9 | 103,9 | 103,9 | 103,9 | -6,3 |
| | 20 | Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike | 1,0 | 95,0 | 95,0 | 94,9 | 94,9 | -0,4 |
| | 21 | Përpunimi I produkteve dhe preparateve farmaceutikë | 0,6 | 97,4 | 97,4 | 97,4 | 97,4 | 0,3 |
| | 22 | Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës | 1,8 | 113,7 | 113,7 | 113,7 | 113,7 | -0,9 |
| | 23 | Prodhimi i produkteve minerale jo metalike | 13,6 | 91,5 | 91,4 | 90,2 | 91,1 | 0,5 |
| | 24 | Metalurgjia | 2,4 | 89,5 | 89,5 | 89,5 | 89,5 | 0,1 |
| | 25 | Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve | 7,0 | 99,0 | 98,9 | 98,9 | 98,9 | -2,0 |
| | 27 | Prodhimi i paisjeve elektrike | 0,3 | 105,9 | 105,9 | 105,9 | 105,9 | 1,4 |
| | 28 | Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p.k.t | 0,1 | 102,6 | 102,6 | 102,6 | 102,6 | -0,7 |
| | 29 | Prodhimi I mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove | 0,2 | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 0,0 |
| | 31 | Prodhimi i mobiljeve | 2,5 | 121,1 | 121,5 | 120,8 | 121,1 | 8,4 |
| | 32 | Industri të tjera p.k.t | 0,1 | 112,6 | 112,6 | 112,6 | 112,6 | 0,5 |
| | 33 | Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve | 0,1 | 113,4 | 109,9 | 116,9 | 113,4 | 0,4 |
| D | | Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar | **19,8** | **99,4** | **99,8** | **98,9** | **99,4** | **-0,8** |
| | 35 | Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar | 19,8 | 99,4 | 99,8 | 98,9 | 99,4 | -0,8 |
| E | | Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve | **4,4** | **105,1** | **105,1** | **105,1** | **105,1** | **1,8** |
| | 36 | Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve | 3,6 | 112,2 | 112,2 | 112,2 | 112,2 | 1,4 |
| | 37 | Shërbime të trajtimit të kanalizimeve | 0,6 | 101,5 | 101,5 | 101,5 | 101,5 | 0,8 |
| | 38 | Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve | 0,2 | 79,0 | 79,0 | 79,0 | 79,0 | 0,1 |

**Tab. 4 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për eksport**

2010 = 100 %

| NVE | | Përshkrimi | Peshat | 01 - 15 | 02 - 15 | 03 - 15 | I - 15 | I-15 / IV-14 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Gjithsej** | **100,0** | **104,2** | **104,6** | **105,0** | **104,6** | **0,1** |
| B | | Industri Nxjerrëse | **31,3** | **96,9** | **97,1** | **98,7** | **97,6** | **0,0** |
| | 06 | Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror | 19,3 | 94,5 | 96,2 | 97,7 | 96,2 | 0,8 |
| | 07 | Nxjerrja e mineraleve metalore | 11,4 | 93,3 | 91,4 | 92,8 | 92,5 | 2,1 |
| | 08 | Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat | 0,6 | 102,2 | 102,2 | 102,2 | 102,2 | 0,9 |
| C | | Industria Përpunuese | **63,9** | **106,4** | **106,8** | **106,7** | **106,6** | **0,5** |
| | 10 | Përpunimi i produkteve ushqimore | 6,1 | 104,3 | 104,2 | 104,2 | 104,2 | -1,0 |
| | 11 | Prodhimi i pijeve | 0,4 | 103,9 | 103,9 | 102,7 | 103,5 | 1,6 |
| | 13 | Përpunimi i tekstileve | 0,5 | 116,4 | 116,4 | 116,4 | 116,4 | 0,3 |
| | 14 | Konfeksionimi i veshjeve | 7,6 | 107,2 | 107,2 | 107,5 | 107,3 | 2,0 |
| | 15 | Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure | 8,7 | 108,9 | 109,4 | 109,7 | 109,3 | 0,0 |
| | 16 | Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi | 1,3 | 111,0 | 110,9 | 111,2 | 111,0 | -0,6 |
| | 17 | Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre | 1,5 | 105,5 | 105,5 | 105,5 | 105,5 | 1,2 |
| | 19 | Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës | 2,1 | 100,9 | 102,5 | 100,9 | 101,4 | 0,6 |
| | 20 | Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike | 1,2 | 109,1 | 109,1 | 109,1 | 109,1 | 6,7 |
| | 22 | Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës | 1,0 | 123,3 | 123,3 | 123,3 | 123,3 | 1,5 |
| | 23 | Prodhimi i produkteve minerale jo metalike | 6,5 | 148,9 | 149,4 | 149,4 | 149,2 | -0,3 |
| | 24 | Metalurgjia | 17,9 | 99,4 | 100,7 | 100,1 | 100,1 | -0,5 |
| | 25 | Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve | 5,1 | 114,0 | 113,1 | 113,1 | 113,4 | 5,2 |
| | 26 | Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë | 0,1 | 104,8 | 104,8 | 104,8 | 104,8 | 0,7 |
| | 27 | Prodhimi i paisjeve elektrike | 1,0 | 111,7 | 111,7 | 111,7 | 111,7 | 0,1 |
| | 28 | Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p.k.t | 0,3 | 111,0 | 111,0 | 111,0 | 111,0 | 0,1 |
| | 29 | Prodhimi I mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove | 0,4 | 105,1 | 105,1 | 105,1 | 105,1 | 5,1 |
| | 31 | Prodhimi i mobiljeve | 1,6 | 105,7 | 105,1 | 105,9 | 105,5 | -2,7 |
| | 32 | Industri të tjera p.k.t | 0,5 | 102,9 | 102,9 | 102,9 | 102,9 | -2,7 |
| | 33 | Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve | 0,1 | 95,0 | 95,0 | 95,0 | 95,0 | -6,7 |
| E | | Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve | **4,8** | **100,5** | **102,0** | **103,1** | **101,9** | **-4,8** |
| | 38 | Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve | 4,8 | 89,2 | 90,6 | 91,6 | 90,5 | -2,3 |

# Informacion për përdoruesit

INSTAT në vijim të procesit të llogaritjes dhe publikimit të treguesve statistikorë, publikon Indeksin e Çmimeve të Prodhimit që nga tremujori i dytë 2014 mbështetur në Nomenklaturën e Aktiviteteve Ekonomike, NVE Rev.2.

Aplikimi i Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev,2, bëhet me akt ligjor të miratuar me VKM Nr 320 datë 28.05.2014, http://www.instat.gov.al/media/252541/nve.pdf

INSTAT gjithashtu si rrjedhojë e detyrimeve që ka ndaj Eurostat, për përshtatshmëri të plotë të statistikave shqiptare me ato të vendeve Europiane, ka përditësuar periudhën referuese të llogaritjes së indeksit nga 2005 = 100 në 2010 = 100.

Për kalimin e aktiviteteve ekonomike nga nomenkatura e vjetër në nomenklaturën e re si dhe për rivlerësimin e të dhënave në seri kohore u përdorën matricat e konvertuara të llogaritura mbi rezultatet e Anketave Strukturore Pranë Ndërmarrjeve Ekonomike jo-bujqësore. Seria kohore e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit ,për periudhën 2005 – Tremujori i katërt 2014 është përditësuar me rezultatet e llogaritura në nivel produkti 6-shifror dhe Nomenklatura u zbatua në nivel të detajuar ( mikro). Kjo solli ndryshim të disa rezultateve të publikuara më parë në nivel të agreguar 2 shifror dhe në nivel seksioni.

**INSTAT llogarit dhe publikon:**

· Indeksin e Çmimeve të Prodhimit Gjithsej

· Indeksin e Çmimeve të Prodhimit të Produkteve për Tregun vendas,

· Indeksin e Çmimeve të Prodhimit për Eksport

**Fusha e mbulimit:**

Seksioni B - Industria Nxjerrëse

Seksioni C – Industri Përpunuese

Seksioni D - Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar

Seksioni E - Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit

**Llogaritja e indeksit**

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas degëve të ekonomisë në nivel 2-shifror. Rinovimi i shportës së ndërmarrjeve dhe produkteve realizohet çdo vit duke përdorur rezultatet e Anketës Strukturore pranë Ndërmarrjeve Ekonomike jo Bujqësore. Përcaktimi i peshave të produkteve me destinacion tregun vendas mbështetet në rezultatet e po kësaj ankete, ndërsa peshat e produkteve me destinacion eksportin mbështeten në të dhënat statistikore të Tregtisë së Jashtme.

Duke filluar nga tremujori i dytë 2014 e në vazhdim Indeksi i Çmimeve të Prodhimit do të ketë si periudhë referuese vitin 2010 = 100. Metoda e llogaritjes së indeksit është metoda zinxhir (Laspeyres - chain index) sipas së cilës, çmimi i produktit në periudhën korente (y) krahasohet me çmimin e muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm (y – 1).

$$I_{2010}^{y,m} = \frac{100}{\frac{1}{12}\sum_{M=JAN}^{DEC} I_{2010,Dec}^{2010,M}} \times \prod_{Y=2010}^{y-1} I_{Y-1,dec}^{Y,dec} \times I_{y-1,dec}^{y,m}.$$

- Pjesa e parë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve të muajit Dhjetor 2010 krahasuar me mesataren e çmimeve në vitin 2010 (2010 = 100).

- Pjesa e dytë e formulës tregon lëvizjen zinxhir të indeksit të çmimeve nga muaji Dhjetor 2010 deri në periudhën y-1.

- Pjesa e tretë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve nga muaji Dhjetor y-1 në muajin m të vitit y.

Me qëllim prodhimin e të dhënave në formën e serive kohore afatgjata indekset janë rillogaritur duke aplikuar matricat e konvertuara në nivel mikro ( 6 – shifror) e cila sjell revizionim të rezultateve të publikuara më parë. Për të patur seri kohore më konsistente dhe më të krahasueshme me seritë kohore me periudhë referuese 2005 = 100, u revizionuan të gjithë të dhenat e publikuara më parë me NVE.Rev.2 dhe 2010 = 100.

**Matësit e Indeksit**

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar, Ky

ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve vjetore në nivelet e çmimeve por mund të ndikohet edhe nga efektet e

papërsëritshme të çdo tremujori.

Ndryshimi tremujor krahason nivelet e çmimit të dy tremujorëve të fundit.